



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI I BASHKIAK

Nr. 374/2 Prot.

Pukë, më 18 .02 .2025

Lënda: Njoftim për mbledhjen e këshillit bashkiak Pukë.

Antarëve të Këshillit të Bashkisë Pukë

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim të vendimit të kryesisë së këshillit nr. 1 datë 18 .02.2025, mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Pukë do të zhvillohet me datën **25 .02 .2025** ,ora **14:00** tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend - dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 22.01.2025
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Janar** 2025.
3. Projekt-vendim " Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026"
4. Projekt-vendim " Per miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Pukë , njësisive administrative, Institucioneve të vartësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025"
5. Rishqyrtim i VKB nr.55 datë 03.12.2024 " Për miratimin e planit të mbarshimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Gomsiqe në NJA Qerret, Pukë, të Bashkisë Pukë"
6. Projekt-vendim "Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri 6% te fondit"
7. Projekt-vendim :” Për një shtesë në VKB nr. 64 datë 27.12.2024 ” Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”
8. Të tjera.

Shënim: Mbledhjet e komisioneve të përherëshme të këshillit zhvillohen më datë 24. 02 .2025, nga ora 13-⁰⁰ deri ne oren 16 ⁰⁰ në zyrën e sekretarit të këshillit.

Duke ju falenderuar për mirekuptimin dhe bashkëpunim, ju lutem konfirmoni pjesëmarrjen ne mbledhje!

SEKRETARI

Hazbi TERBUNI

